

Sumeja Morina Pllana

*SHTYLLATE E
ISLAMIT*

(PËRMBLEDHJE E SHKURTËR)

Mitrovicë, 2022

Titulli: Shtyllat e islamit

Përmblodhi: **Sumeja Morina Pllana**

Redaktor fetar: **Flamur Kabashi**

Redaktor gjuhësor: **Arditë Shabani Podrimaj**

Radhitja kompjuterike & Kopertina: **Afrim Radoniqi**

Parathënie

Falënderimi i takon Allahut të Lartësuar, Atë e falënderojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Dëshmoj se askush nuk meriton të adhurohet me të drejtë përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem, është rob dhe i Dërguari i Tij.

Lexues i/e nderuar, libri në vijim vjen si përbledhje ose version i shkurtër i shtyllave të islamit. Ky libër është i përshtatshëm për çdo lexues i cili dëshiron të ketë njohuri bazë rrëth çështjeve fetare, po ashtu i përshtatshëm për çdo fillestare që dëshiron të njihet me kushtet e fesë. Libri vjen edhe si ndihmesë për çdo prind që dëshiron t'a informojë fëmiun e tij dhe të i'a mësoj shtyllat e islamit.

Libri trajton në formë të shkurtuar çdo shtyllë të fesë, duke filluar nga Shehadeti, Namazi, Zekati, Agjërimi dhe Haxhi.
Vetëm prej Allahut vjen suksesi!

Përbloodi: Sumeja Morina Pllana

SHTYLLAT E ISLAMIT

Islami është i ndërtuar mbi pesë shtylla kryesore që e përbëjnë bazën e fesë. Ato janë: Shehadeti (Dëshmia), Namazi, Zekati, Agjërimi dhe Haxhi.

Argument për këtë është hadithi ku i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ves-sel-lem thotë: "*Islami është ngritur mbi pesë shtylla: Dëshmia se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, kryerja e haxhit dhe agjërimi i muajit të ramazanit.*" (Transmeton Buhariu)

Shehadeti- është kushti i parë i pranimit dhe hyrjes në islam, do të thotë është gjëja e parë që kërkohet prej jomuslimanëve kur ata ftohen në islam.

Është fjala me të cilën Allahu dëshmoi për vetveten e Tij, dëshmuani melaiket dhe të diturit nga krijesat e Tij. Allahu i Lartësuar thotë: "*Allahu dëshmoi se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij, dëshmuani edhe melaiket e dijetarët dhe se Ai ështe Zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot tjetër që meriton adhurimin përveç Tij, Fuqiplotit e të Urtit.*" (Ali-Imran, 18).

Fjala “LA ILAHE IL-LALLAH” - ka dy shtylla:

Shtylla e parë: Mohimi *La ilah*, nuk ka asnje zot që meriton të adhurohet me të drejtë. Me këtë pjesë hidhen poshtë të gjitha llojet e besimeve dhe mohohen të gjithë ata që adhurohen.

Shtylla e dytë: Pohimi *Il-lallah*, përveç Allahut, këtu pohohet dhe vërtetohet se nuk ka të adhuruar me meritë përveç Allahut.

KUSHTET E FJALËS “LA ILAHE IL-ALL-LAH”

1. Kushti i parë është DITURIA dhe e kundërta e saj është padituria (injoranca)

Ky kusht do të thotë, secili që e thotë këtë fjalë duhet ta dijë se vetëm Allahu duhet të adhurohet dhe nuk lejohet që askush dhe asgjë t'i bëhet shok Atij në këtë adhurim. Allahu i Lartësuar thotë: ”**Dije se nuk meriton askush të adhurohet pos Allahut. Kërko falje për gjynahun tënd dhe të besimtarëve, All-lahu e di se si silleni dhe ku qëndroni.**” (Muhammed, 19).

Uthman ibn Affani Allahu goftë i kënaqur me të transmeton se i Dërguari i Allahut sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem, ka thënë: ”*Ai i cili vdes duke e ditur se nuk meriton të adhurohet me të drejtë askush tjetër, pos Allahut do të hyjë në xhennet.*” (Transmeton Buhariu).

Mënyrat për të kuptuar se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut janë:

- E para: Meditimi mbi Emrat dhe Cilësitë e Allahut, që tregojnë qartë Përsosmërinë e Tij, Madhështinë dhe Fisnikrinë e Tij.

- E dyta: Dija që Allahu është Ai i Cili krijon, rregullon dhe sistemon çdo gjë.
- E treta: Dija që Ai është Dhuruesi i Vetëm i të gjitha mirësive, të dukshme e të padukshme, fetare dhe materiale.
- E katërta: Dija rrreth shpërblimeve për të cilat ka treguar Allahu në Kuran dhe Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi vese-sel-lem, në hadithe të cilat u janë premtuar atyre që i kryejnë urdhërat dhe largohen nga ndalesat, të cilët e pranojnë dhe i nënshtohen Zotit të tyre.
- E pesta: Dija mbi cilësitë dhe aftësitë e idhujve që adhurohen në vend të Allahut ose bashkë me të, njohja se ata janë të dështuar në të gjitha aspektet, të varfër dhe të paaftë që të përfitojnë apo t'i dëmtojnë vetvetët e tyre, ose t'iu bëjnë dobi njerëzve. Ata nuk kanë fuqi të japid e as të marrin jetë ose që të ringjallin. Nuk mund t'iu largojnë të keqen njerëzve e as nuk mund t'iu sjellin fat, mirësi e mbarësi.
- E gjashta: Dija se shkrimet apo librat e shenjta që i ka shpallur Allahu i Lartësuar, janë në hamroni me njëratjetrën dhe në përputhje me dëshminë, "La ilaha il-lAllah."
- E shtata: Dija se më të zgjedhurit nga mesi i njerëzve janë pejgamberët.
- E teta: Meditimë në krijimtarinë e Allahut, në univers dhe atë që na rrrethon, ekzistanca e krijesava të Tij,

shumëlojshmëria e krijimeve të Tij janë argumente që tregojnë qartë njehësimin e Allahut, krijimin e Tij dhe Urtësinë e Tij.

2. Kushti i dytë është BINDJA dhe e kundërta e saj është dyshimi

Bindja është kushti i dytë i fjalës, "La ilahe il-lAllah", kusht i cili hedh poshtë çdo dyshim dhe kërkon që ai që e thotë këtë dëshmi të jetë i bindur për kuptimin që ka kjo dëshmi, në mënyrë që t'i zhduken të gjitha dyshimet që i pëshpërit shejtani apo që mund t'i lindin në besimin dhe zemrën e tij. Argument për bindjen është thënia e Allahut të Lartësuar në Kuran: **"Besimtarë janë vetëm ata që i besuan Allahut dhe të Dërguarit të Tij, e pas kësaj nuk dyshuan por luftuan me pasurinë dhe jetën e tyre në rrugë të Allahut. Ata janë besimtarë të sinqertë."** (Huxhurat, 15).

Në këtë ajet Allahu subhanehu ve teala, e bënë kusht bindjen për besimin e vërtetë, sepse ai i cili ka dyshime për besimin e tij llogaritet prej hipokritëve.

Si dhe hadithi që e transmeton Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të, i cili thotë se: i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem, ka thënë: **"Ai rob që e takon Allahun duke dëshmuar se nuk ka të adhuruar me të drejtë përvëç Allahut dhe**

se unë jam i Dërguar i Allahut, duke mos pasur dyshim në të, do të hyjë në xhennet.” (Transmeton Muslimi)

3. Kushti i tretë është PRANIMI dhe e kundërta e saj është refuzimi

Pra, muslimani duhet të pranojë gjithçka që ka të bëjë me këtë dëshmi, duke filluar nga kuptimi dhe përmbajtja e saj deri tek kushtet dhe detyrimet që i obligon ajo.

Allahu i Lartësuar thotë: ”Për arsy se kur u thuhej atyre: ”Nuk ka zot tjetër (të dejnë për adhurim) veç Allahut”, ata tregoheshin arrogant. Dhe thoshin: ”A do t’i braktisim zotat tanë për një poet të çmendur?!” (Saffat, 35-36).

Do të thotë, të pranojë me zemër, me gjuhë dhe me vepra tërë atë që kërkohet nga kjo fjalë. Refuzimi i obligimeve është në kundërshtim me vetë dëshminë, ”La ilahe il-Allah” dhe bie ndesh me të.

4. Kushti i katërt është NËNSHTIRMI dhe e kundërta e saj lënia (mosnënshtrimi)

Kushti i katërt i dëshmisë "La ilahe il-Allah", është nënshtrimi me të cilën muslimanit i kërkohet që t'u nënshtrohet kushteve të kësaj dëshmie, pra janë detyrimet që muslimani është i obliguar t'i zbatoj me devotshmëri dhe sinqeritet për Allahun, duke kërkuar knaqësinë e Tij. Dhe e kundërta është mosnënshtrimi dhe dalja nga robërimi i Allahut, duke rënë në robërinë e epsheve dhe shejtanëve nga mesi i xhinëve dhe njerëzve. Argument për nënshtrim është fjala e Allahut të Lartësuar: "**Kthehuni tek Zoti juaj me pendim dhe nështrojuni Atij...**" (**Zumer, 54**)

Allahu i Lartësuar po ashtu thotë: "**Dhe kush mund të jetë më i mirë në fe sesa ai që i nënshtrohet sinqerisht Allahut dhe punon mirësi...**" (**Nisa, 125**)

Ndërsa, Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem, ka thënë: "*Asnjëri prej jush nuk ka për të besuar derisa dëshirat tuaja të ndjekin atë me të cilën unë u dërgova.*" (Transmeton Muslimi)

5. Kushti i pestë është VËRTETËSIA dhe e kundërta e saj është gënjeshtra

Ky është kushti që e pastron njeriun nga të mashtruarit, të gënjerit dhe hipokrizia. Robi duhet ta thotë këtë dëshmi duke qenë i vërtetë në zemrën e tij dhe jo thjeshtë sa për t'u dukur e për t'i gënjerit të tjerët sikur je besimtarë, ndërkohë që ti je prej atyre që mohojnë.

Argument për vërtetësinë është fjala e Allahut të Lartësuar në Kur'an: "Elif, Lam, Mim. A menduan njerëzit të thonë: "Ne kemi besuar", e të mos vihen në sprovë? Ne i sprovuam ata që ishin para tyre, ashtu që Allahu gjithsesi do t'i dallojë ata që e thanë të vërtetën e do t'i dallojë gënjeshtarët."

(Ankebut, 1-3)

6. Kushti i gjashtë është SINQERITETI dhe e kundërta e saj hipokrizia

Sinqeriteti është kushti që e pastron veprën nga shirku (të bërit ortak Allahut), me qëllim që personi i cili e thotë dëshminë ia kushton adhurimin e tij vetëm Allahut dhe askujt tjetër veç Tij. Allahu i Lartësuar thotë: "...Ti adhuroje Allahun duke qenë i sinqertë në adhurimin e Tij." (Zumer, 2)

Dhe poashtu Ai (Allahu) ka thënë: **”Dhe ata nuk u urdhëruan për gjë tjetër vetëm se ta adhuronin Allahun me adhurim të sinqertë ndaj Tij.”** (Bejjineh, 5).

Transmetohet nga Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të, se i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem, ka thënë: *”Njeriu më i lumtur që do të ketë ndërmjetësimin tim (në ditën e gjykimit), do të jetë ai që ka thënë “La ilahe il-Allah”, me singjeritet nga zemra.*” (Transmeton Buhariu).

7. Kushti i shtatë është DASHURIA dhe e kundërta e sajurrejtja

Muslimanit i kërkohet të ketë dashuri ndaj kësaj dëshmie dhe përbajtjen e saj, t'i dojë ata që veprojnë në përputhje me këtë dëshmi dhe të jetë i lumtur me të. Allahu i Lartësuar thotë: **”E megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerrë, (duke i konsideruar) si të barabartë me Atë dhe duke i dashur siç duhet Allahu. Por ata që besojnë e duan më shumë Allahun (sesa i duan idhujtarët, idhujt e tyre)...”** (Bekare, 165)

Enesi Allahu qoftë i kënaqur me të, transmeton se i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem, ka thënë:
”Kushdo që i ka këto cilësi do të arrijë ëmbëlsinë e imanit: Allahu dhe i Dërguari i Tij të jenë më të dashur për të sesa çdo gjë tjetër, ta

dojë një njeri vetëm për hir të Allahut dhe të urrejë të kthehet në kufër pas besimit ashtu sikurse urren të hudhet në zjarr.”
(Transmeton Buhariu).

8. Kushti i tetë është mohimi i çdo gjëje që adhurohet përvèç Allahut.

Fjala *tagut*, ka kuptimin e tejkalimit të kufirit. Tagut konsiderohet ai që vetes i jep kompetenca që i takojnë vetëm Allahut siç janë: sundimi, adhurimi, pushteti, bindja, gjykimi etj., gjithashtu tagut konsiderohet edhe ai i cili kërkon të adhurohet dhe populli e merr si të adhuruar në vend të Allahut, d.m.th e pason, imiton dhe adhuron në forma me të cilat adhurohet vetëm Allahu, i bindet atij dhe gjykohet tek ai. Prandaj muslimani duhet të urrejë çdo gjë që adhurohet në vend të Allahut si dha ata që adhurojnë idhujt dhe bien në kundërshtim me dëshminës.

Allahu i Lartësuar thotë: ”**Kush nuk e beson tagutin (gjithçka që adhurohet ne vend të Allahut) dhe beson Allahun, ai është kapur për lidhjen më të fortë e cila nuk ka shkëputje...**”
(Bekare, 256).

SHTYLLAT E DËSHMISË “MUHAMMEDUN RESULULLAH”

Dëshmia Muhammedun Resulullah - ka dy shtylla:

Shtylla e parë: Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem është rob i Allahut të Lartësuar- Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem ka qenë rob i Allahut, nuk ka cilësi hyjnore dhe nuk ka ditur asgjë nga e fshehta përpos asaj që Allahu subhanahu ve teala e ka lajmëruar. Ka qenë njeri që ka ngrënë, ka pirë, është martuar, është hidhëruar, është gëzuar, ka jetuar dhe ka vdekur. Allahu i Lartësuar thotë në Kur'an: **"Falënderimi i takon Allahut që i shpalli robit të Vet (Muhammedit), Librin dhe në të nuk lejoi kundërthënie."** (Kehf, 1).

Shtylla e dytë: Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem është i Dërguar i Allahut.

Allahu i Lartësuar thotë: **"Muhammedi nuk është tjetër vetëm se i Dërguar edhe para tij pati të dërguar (që u vranë ose vdiqën)..."** (Ali Imran, 144).

Kushtet e fjalës Muhammedun Resulullah:

1. Të adhurohet Allahu me sunnetin e Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem.

Pra ibadetet nuk bëhen ndryshe vetëm ashtu siç i ka vepruar Muhammedi sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem. Prandaj nëse njeriu e adhuron Allahun me një formë të ibadetit që nuk e ka vepruar Muhammedi sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem, ajo konsiderohet risi në fe (bidat).

Pejgamberi sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem ka thënë: "*Kush vepron diçka që nuk është në pajtim me çështjen tonë, ajo vepër është e refuzuar.*"

(Transmeton Muslimi)

2. Dashuria ndaj Pejgamberit sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem

Pejgamberi sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem, të jetë më i dashur për ty se vetja yte, prindërit, fëmijët dhe çdokush tjetër. Pejgamberi alejhi sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem, ka thënë: "*Askush nga ju nuk ka besuar (me besim të plotë) pëderisa nuk më do mua më shumë se fëmijët e tij, prindërit e tij dhe tërë njerëzimin.*" (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

3. Besimi në gjithë atë që e ka thënë Pejgamberi sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem

Besimi se ajo që ka treguar Pejgamberi sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem është pjesë e shpalljes prej Allahut, pavarësisht a flet për ndonjë çështje të kaluar, lajm për të tashmën apo për të ardhmën, pasi të është vërtetuar saktësia e hadithit. Të besuarit se Muhammedi sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem nuk flet nga hamendja e tij por me shpallje nga ana e Allahut.

Allahu i Lartësuar thotë: **”Ai nuk flet nga hamendja e tij, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij.”** (Nexhm, 3-4).

4. Bindja ndaj të Dërguarit të Allahut

Çdo musliman ka detyra ndaj Pejgamberit sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem e që janë ndjekja e këshillave të tij, kapja për sunnetin e tij dhe dashuria ndaj tij, pasimi i sunnetit dhe largimi nga ajo çka ndaloi dhe paralajmëroi. Allahu i Lartësuar thotë: **”Dhe bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, që të mund të mëshiroheni.”** (Ali Imran, 132)

Pejgamberi sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem ka thënë: **”Kush më bindet mua i është bindur Allahut.”** (Transmeton Buhariu dhe Muslimi).

5. Mosdhënia përparësi fjalës së askujt para fjalës së Pejgamberit sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem.

Nuk ngriten fjalët e askujt para fjalëve të Pejgamberit sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem, cilido qoftë ai njeri. Allahu i Lartësuar thotë: ”Le të ruhen ata të cilët kundërshtojnë urdhërat e të Dërguarit se mos iu vie ndonjë sprovë ose që të mos i godasë ndonjë dënim i dhembshëm.” (Nur, 63)

6. Besimi se Pejgamberi sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem është vula e pejgamberëve.

Duhet besuar bindshëm se ky është Pejgamberi i fundit. Nuk pranohet pejgamberllëku i asnjërit pas, Muhammedit sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem. Pejgamberi sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem ka thënë: ”S’ka pejgamber pas meje.” (Transmeton Muslimi)

NAMAZI

Shprehja *es-salatu-* në kuptimin gjuhësor do të thotë, *lutje*. Kurse në aspektin terminologjik: ka kuptimin ”*ibadet i veçantë i cili përbëhet prej fjalëve dhe veprave të posaçme, fillon me tekbir dhe përfundon me dhënien e selamit.*”

Namazi është shtylla e dytë e islamit pas shehadetit dhe është obligim për çdo musliman të rritur. Ai i cili e fal namazin shpërblehet kurse ai i cili e lë bën mëkat të madh, madje është çështje mjaft e diskutuar në mesin e dijetarëve se ai i cili e lë namazin a llogaritet besimtarë apo jo? E krejt kjo duke u bazuar në hadithtin e Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem i cili thotë: ”*Mes njeriut, kufrit dhe shirkut është lënia e namazit.*” (Buhariu dhe Muslimi)

Namazi është bërë obligim në natën e Israsë dhe Miraxhit, ku Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem është ngritur mbi shtatë qiej. Para se të flasim për rregulla të caktuara rreth namazit duhet t'i japim përparësi ajeteve dhe haditheve që flasin për obligueshmërinë e namazit dhe vlerën e tij.

Allahu i Lartësuar thotë në Kur'an: “**Është e sigurtë që kanë shpëtuar besimtarët, ata të cilët janë të përulur dhe të**

kujdeshëm gjatë namazit të tyre.” (Muminun, 1-2)... Po ashtu Ai i Lartësuari thotë: “E ti fale namazin se me të vërtetë namazi të largon nga të shëmtuarat dhe të irrituarat.” (Ankebut, 45)

Gjithashtu Allahu i Lartësuar kur i përmend në Kuran banorët e zjarrit që pyeten çfarë ju solli juve në sekar (vend në xhehenem), ata përgjigjen: “**Ne nuk ishim nga ata që falnin namazin.**” (Mudethir, 43)

Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem për namazin ka thënë: ”*Si mendoni sikur të ishte një lum para derës së çdonjërit prej jush në të cilën do të lahej çdo ditë nga pesë herë, a do të mbetej në të ndonjë ndytësi? Të pranishmit thanë: Jo, nuk do të mbetej asnjë ndytësi. Pejgamberi alejhi selam tha: “Kështu është shembulli i pesë kohëve të namazit. Allahu me faljen e namazeve i shlyen mëkatet.”*” (Transmeton Buhariu)

Gjithashtu fjalët e fundit të Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem para vdekjes ishin: ”*Kujdesuni me namazin dhe ato që i keni në sundimin tuaj.*” (Transmeton Ibn Maxheh)

Kush është i obliguar me namaz?

Namazi është obligim individual për çdo person: musliman, moshërritur dhe i shëndoshë mentalisht.

Por kjo nuk do të thotë që edhe fëmijët të lihen anash sa i përket faljes së namazit sepse është mirë që ata të mësohen edhe më herët sesa të pritet deri në moshën madhore, në mënyrë që namazi t'iu bëhet pjesë e jetës dhe të mos e mendojnë atë si diçka zgjedhore ose si një veprim i caktuar që e bëjnë vetëm kur të duan. E kjo është edhe një porosi nga Pejgamberi alejhi selam i cili ka thënë: ”Urdhëroni fëmijët tuaj me namaz qysh në moshën shtatë vjeçare, rrihni(lehtë) ata në moshën dhjetë vjeçare (nëse nuk falen).” (Transmeton Ebu Davudi)

Cilat janë kohët e namazit?

Namazi i ka pesë kohë farze (*të detyrueshme*):

1. Namazi i sabahut
2. Namazi i drekës
3. Namazi i ikindisë
4. Namazi i akshamit dhe
5. Namazi i jacisë

Secili namaz e ka kohën e caktuar për falje dhe çdo besimtarë është i obliguar t'iu përmbahet. Allahu i Lartësuar thotë në Kur'an: ”**Vërtetë namazi për besimtarët është në kohë të caktuar...**” (En-Nisa, 103)

Kushtet pa të cilat nuk ka vlerë namazi janë:

1. Të jesh musliman
2. Të jesh i aftë mendërisht
3. Të bëhet nijeti për namaz (me zemër)
4. Të ketë hyrë koha e namazit
5. Pastërtia (abdesti ose gusli)
6. Pastrimi i trupit, rrobave dhe vendit të faljes prej ndytësirave
7. Mbulimi i vendeve të turpshme (tek femrat tërë trupi në përjashtim të duarve dhe fytyrës)
8. Të kthyerit kah kibla

Shtyllat e namazit- Bëhet fjalë për shtyllat brenda namazit, pa të cilat namazi nuk ka vlerë dhe nuk pranohet:

1. Tekbiri fillestar (thënia Allahu ekber)
2. Qëndrimi në këmbë
3. Leximi i surës El-Fatiha
4. Rukuja
5. Ngritja nga rukuja dhe të qendruarit në këmbë (qëndrimi drejtë para se të shkohet në sexhde)
6. Rënia në sexhde
7. Ulja e fundit (teshehudi)
8. Dhënia selam
9. Radhitja e formës së namazit
- 10.

Gjërat që e prishin namazin:

1. Nëse lihet ndonjëra nga shtyllat e namazit
2. Ngrënja ose pirja me qëllim
3. Të folurit gjatë namazit
4. Lëvizjet e tepërtë
5. Qeshja me zë
6. Humbja e vetëdijës
7. Prishja e abdestit

Në cilat kohë është e ndaluar falja e namazit?

Namazi vullnetar nuk lejohet të falet pas ikindisë derisa të perëndojojë dielli, pas namazit të sabahut deri të lind dielli dhe kur dielli është në zenit pak para se të hyjë koha e namazit të drekës (20min përafërsisht).

Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem ka thënë: "S'ka namaz pas namazit të ikindisë deri të perëndojojë dielli e pas pas namazit të sabahut deri të lind dielli." Tek namazet farze vlen të ceket se namazi më i mirë është namazi me xhemat.

Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem ka thënë: "Namazi me xhemat është më i vlefshëm se ai që falet vetmas për njëzet e pesë here."

Namazi i xhumasë

Përpos pesë kohëve të namazeve farze, poashtu në islam është e njojur edhe namazi i xhumasë që falet ditën e premte në kohën e namazit të drekës. Namazi i xhumasë është farz individual për çdo person të rritur mashkull dhe të aftë psiqikisht.

Allahu i Lartësuar në Kur'an për namazin e xhumasë thotë: ”**O ju që keni besuar, kur të thirret për t'u falur xhumaja, nxiton përmendni Allahun dhe lëreni shitblerjen...**” (Xhumua, 9)

Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lemka thënë: ”*Dita më e mirë në të cilën ka lindur dielli, është dita e xhuma.*” (Transmeton Muslimi)

Po ashtu i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem ka thënë: ”*Pesë kohët e namazit, xhumaja deri në xuma, ramazani deri në ramazan shlyejnë mëkatet e vogla nëse u ruheni mëkateve të mëdha.*”(Trasnmeton Muslimi)

Sunnetet e ditës së xuma:

1. Gusli apo pastrimi (larja) i tërë trupit
2. Veshja e rrobave të bukurë
3. Parfymosja
4. Të shkuarit më herët në xhami
5. Të ulurit në vend të caktuar pa i penguar të tjera

6. Dëgjimi i hutbes me vëmendje (duhet pasur kujdes sepse nuk lejohet të flitet gjate hutbes)
7. Dërgimi i sa më shumë salavateve
8. Bërja e duave e sidomos para perëndimit të diellit

Namazet vullnetare

Namazet vullnetare apo nafile janë namazet jashtë farzeve, të cilat nuk janë obligative por janë vullnetare dhe janë vepra që i ka vepru Pejgamberi alejhi selam, këto namaze ndryshe njihen edhe si sunnete.

Sunnetet që Pejgamberi sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem i ka falur rregullisht, këtu hyn 12 rekate gjatë ditës d.m.th.: *2 rekate sunnet para sabahut, 4 rekate sunnet para drekës dhe 2 pas saj, 2 rekate sunnet pas akshamit dhe 2 rekate sunnet pas jacisë.*

Namazet tjera vullnetare

- Namazi si shenjë nderimi kur të hyn në xhami, falja e 2 rekateve sunnet
- Namazi pas marrjes së abdesit, 2 rekate sunnet pas marrjes së abdesit
- Namazi i duhasë (paraditës), 2 deri 8 rekate sunnet
- Namazi i vitrit, 3 deri 11 rekate sunnet

- Namazi i taravive që është e preferuar të falet gjatë muajit të ramazanit me 8 apo 20 rekate
- Namazi i natës, i cili fillon me dy rekate dhe falë sa rekate të duash si dhe përfundon me vitër

Shembuj praktikë të përulësisë në namaz

Namazi nuk është vetëm një ibadet i cili bëhet me fjalë dhe veprime të caktura fizike, por është një ibadet që kërkon përulje dhe përkushtim gjatë faljes së tij.

Disa shembuj praktikë që ndihmojnë në koncentrimin e namazit:

1. **Nijeti** - besitmari në namazin e tij të ketë për qëllim ta kryejë një obligim para Allahut të Lartësuar, këtë obligim ta kryje me nijetin që vetëm Allahu e meriton të adhurohet, ta ketë për qëllim që me këtë adhurim Allahu ta udhëzojë, t'ia falë mëkatet, ta mëshirojë, ta shpërblejë, ta fusë në xhennet nga dyert e namaz-falësve dhe ta shpëtojë nga zjarri. Ta dijë robi se Allahu nuk ka nevojë për adhurimin tonë sepse Ai është i Lavdëruar e adhuruam ne apo jo, kurse ne jemi ata që kemi nevojë për udhëzimin e Tij, faljen, mëshirën, shpërblimin dhe çdo ndihmë që na vjen nga Ai i Lartësuari.

2. **Të kërkojë mbrojtjen e Allahut nga shejtani i mallkuar**-
pasi shejtani më së shumti e shfrytëzon namazin që robin ta

dekoncentrojë dhe gjatë namazit ta angazhojë me mendime rreth çeshtjeve të dynjasë, në këtë formë shejtani mundohet që t’ia humb robit sa më shumë shpërblimin e namazit.

- 3. Kuptimi i ajeteve që i lexon gjatë namazit-** për koncentrim është e preferuar që robi të mësojë kuptimin e ajeteve që i lexon gjatë namazit, sepse kjo i ndihmon në përkulje dhe koncentrim në namaz.
- 4. Ndryshimi i sureve-** robi të mësojë disa sure edhe nëse janë të shkurtëra me qëllim që namazin ta falë me sure të ndryshme duke ia ditur kuptimin që namazi i tij të mos shndrrohet në rutinë.
- 5. Ta mësoj kuptimin e duave-** do të thotë, të mësojë kuptimin e duave gjatë rukusë, sexhdes, teshehudit me qëllim që ta përjetojë rukunë dhe sexhden.
- 6. Ta falë namazin sikur të jetë namazi i fundit-** secili njeri kur punon ndonjë punë për herë të fundit mundohet ta përsosë atë, prandaj ta falim çdo namaz sikurse të jetë namazi i fundit. Ne nuk e dijmë pas këtij namazi a do të kemi mundësi të falim namaz tjeter dhe në këtë formë t’ia dorzojmë Allahut këtë vepër ashtu siç i takon Atij.

Vërejtje: Kjo ishte sa i përket në pikë të shkurtëra namazit si shtyllë e dytë e islamit. Këtu janë cekur vetëm disa rregulla të caktuara të namazit, sepse qëllimi nuk është të thellohem i një çështjet e fikhet sa i përket namazit dhe për këtë duhet libër i posaçëm, por të japim një rezyme të përgjithshme rrëth namazit dhe rëndësisë së tij. Pra egzistojnë edhe rregulla tjera që i përkasin namazit dhe të cilat gjenden në fikhun e namazit.

ZEKATI

Shprehja "zekat", në gjuhën arabe ka kuptimin: shtim, pastrim, begati. Ndërsa në kuptimin terminologjik: "*Pjesë e caktuar fetarisht, në pasuri të caktuar ndaj kategorive të caktuara, në mënyrë të caktuar dhe ajo pasuri të jepet vetëm për hir të Allahut të Lartësuar.*"

Me shprehjen "*Pjesë e caktuar fetarisht*", nënkupton pasurinë e caktuar nga e cila obligohet të jepet zekati. "*Në pasuri të caktuar*", do të thotë 2.5% në të holla, ose 5% apo 10% në drithëra, qoftë pasuri në të holla, ari, argjend, bagëti etj. "*Ndaj kategorive të caktuara*" - kategoritë e caktuara të zekatit janë të përmendura ne ajetin kuror për të cilat do të shpjegohet tutje. "*Dhe ajo pasuri të jepet vetëm për hir të Allahut*", pra me dhënen e saj të jetë për qëllim vetëm knaqësia dhe zbatimi i urdhërit të Allahut të Lartësuar.

Pozita e zekatit në islam

Zekati konsiderohet si shtylla e tretë në islam pas shehadetit dhe namazit. Është bërë obligim në vitin e dytë hixhrij, në muajin Sheval. Obligimi i tij është vërtetuar me ajete, hadithe dhe ixhma (konsensus), të dijetarëve.

Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: ”**Merr prej pasurisë së tyre lëmoshë që t’i pastrosh me të dhe t’u shtosh të mirat.**” (Teube, 103)... Po ashtu thotë: ”**Elif, Lam, Mim.** Ky është libër që s’ka dyshim në të. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit që e besojnë të fshehtën, falin namazin dhe nga ajo që u kemi dhënë ata japin.” (Bekare, 1-3)

Zekati është farz (obligim) i prerë dhe ai i cili e jep shpërbilehet, kurse ai i cili e lë këtë obligim bënë mëkat. Allahu i Lartësuar në një ajet tjetër kuranor thotë: ”**Ata që e deponojnë arin dhe argjendin dhe nuk e japin në rrugën e Allahut lajmëroi për një dënim të dhembshëm.**” (Teube, 34)

Personi që duhet ta jap zekatin, duhet t’i plotësojë këto kushte:

1. Të jetë musliman
2. I moshërritur
3. Të jetë i lirë, do të thotë, robi nuk e ka obligim zekatin
4. Sasia e pasurisë të ketë arritur nisabin. Nisab është kufiri i pasurisë me të cilën obligohemi ta nxjerim zekatin
5. Kalimi i një viti duke poseduar nisabin e pasurisë
6. Posedimi i plotë i pasurisë do të thotë, personi ta ketë pasurinë në duart e tij, pra pasuria të mos jetë pronë e vakufit apo e shoqatave bamirëse etj

Kushtëzohet që personi i cili e jep zekatin ta bëjë nijet për zekat, kurse nuk është kusht që marrësi i zekatit ta dijë se ajo pasuri është zekat.

Pasuritë në të cilat obligohet zekati:

1. Zekati në kafshë
2. Zekati i arit dhe argjendit
3. Zekati i mallrave tregtare
4. Zekati i drithërave

Kategoritë e zekatit:

Kategoritë e zekatit janë të shpjeguara me ajetin në Kuran, ku Allahu i Lartësuar thotë: ”**Allahu caktoi obligim që lëmosha e zekatit t’u takojë: të varfërve, të ngratëve, punojnësve, atyre që duhet përfituar zemrat. Duhet dhënë edhe për lirim nga robëria, të mbyturve në borxhe, në rrugën e Allahut dhe atij që ka mbetur në rrugë. Vërtet Allahu është i Gjithdijshëm dhe i Urtë.**” (Teube, 60)

Nga ky ajet Kuranor kuptojmë se zekati iu takon:

- Të varfërve
- Të ngratëve
- Atyre qe e tubojnë zekatin (që i cakton prijësi fetar)
- Personave, të cilët duam t’ua perfitojmë zemrat

- Për lirimin e robërve
- Të ngarkuarit me borxhe
- Për në rrugën e Allahut
- Për udhëtarin që ka mbetur në rrugë

Veprimet e pëlqyera për personin që e jep zekatin:

1. Ta bëjë për Allah, e ta largojë syefaqësinë
2. Të mos ia përmend zekatin atij që ia ka dhënë
3. Ta falënderojë Allahun e Lartësuar që ia mundësoi ta kryejë këtë obligim

Zekati i fitrit (*sadakatulfitri*)

Zekati i fitrit është zekati që jepet në fund të Ramazanit e deri para faljes se namazit të bajramit. Ky adhurim ka për qëllim pastrimin nga fjalët dhe veprat që ndikojnë tek robi ta pakësojnë shpërblimin e agjërimit dhe në anën tjetër është shenjë solidariteti me të varfurit. Përmes dhënies së tij robi shfaq falënderimin për dhunitë e Allahut ndaj tij, me plotësimin e agjërimit të ramazanit dhe lehtësimin e veprave të mira që i ka bërë gjatë këtij muaji.

Nga Buhariu dhe Muslimi transmetohet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ves-sel-lem e ka bërë obligim dhënien e zekatit të fitrit, dhe ai jepet për çdo musliman qoftë femër apo mashkull, i

lirë apo rob, fëmijë apo i rritur. Për këtë janë të pajtimit të gjithë dijetarët.

Llojet e ushqimeve për zekatin e fitrit:

Është vërtetuar nga Ebu Seid el Hudrij se ka thënë: ”*E jepnim zekatin e fitrit në kohën e Pejgamberit sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem, një “sa” ushqim, një “sa” hurma, një “sa” elb apo një “sa” rrush të terur...*” (Buhariu dhe Muslimi)

Më e mira është të përkufizohemi në këto lloje të ushqimit, nëse gjendet kush ushqehet me ato shkaku i praktikimit të sunnetit të Pejgamberit sal-lall-lahu alejhi ves-sel-lem, përndryshe nëse nuk gjenden shumica e dijetarëve janë të mendimit se zekati i fitrit jepet nga ushqimet e përdorura në atë vend. Një “sa”, sot llogaritet sa dy kilogramë e gjysmë përafërsisht, d.m.th., kjo është ajo që obligohet të jepet, kurse çka jepet më tepër llogaritet si sadaka vullnetare.

Koha e dhënies se zekatit të fitrit jepet në dy kohë:

Koha e lejuar- para ditës së Bajramit një apo dy ditë dhe

Koha e preferuar- prej perëndimit të diellit në natën e bajramit, kurse mes saj koha më e vlefshme është mes namazit të sabahut dhe atij të bajramit dhe nuk lejohet asesi të vonohet pas faljes së namazit të bajramit.

Zekati i fitrit jepet vetëm për personat e varfër, jo për kategoritë e përmendura te zekati obligativ që folëm më herët, por kjo iu jepet vetëm të varfërve.

Sadakaja vullnetare

Sadakaja në konceptin e përgjithshëm vjen në kuptimin e bamirësisë, kurse në konceptin specifik nënkupton ofrimin e ndihmës materiale për hir të Allahut.

Krahas zekatit obligativ dhe zekatit të fitrit veprave të bamirësisë në islam i shtohet edhe sadakaja vullnetare. Për dallim nga zekati, sadakaja nuk ka kategori të caktuar se kujt duhet t'i jepet por parapëlqehet që të jepet aty ku ka më së shumti nevojë.

Sadakaja më e mirë është ajo e vazhdueshme që njerëzit përfitojnë në vazhdimësi prej saj prandaj ajo mund të jepet për ndërtimin e xhamive, shkollave, spitaleve, bunareve prandaj për të gjitha këto kategori konsiderohet sadaka rrjedhëse shpërblimi i të cilës vazhdon edhe pas vdekjes së personit që ka kontribuar në sadaka të tilla.

Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem ka thënë: “*Nëse njeriu vdes, veprimet e tij ndalen, përveç në tri raste: një lëmoshë e vazhdueshme, një dije e dobishme dhe fëmiu i mirë i cili lutet përtë.*” (Transmeton Muslimi)

Por sadakaja në islam nuk është e përkufizuar vetëm në aspektin material, sepse Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem, në hadithet e sadakasë ka përmend edhe buzëqeshjen ndaj vëllaut, punën e mirë, lehtësimin e ndonjë prej nevojave të muslimanëve etj... Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem, ka thënë: ”*Çdo punë e mirë është sadaka.*” (Transmeton Buhariu)

Vlera e sadakasë

Sadakaja është mburojë nga zjarri- Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem, ka thënë: ”*Ruajuni nga zjarri qoftë edhe me gjysmë hurme.*” (Transmeton Nesaiu)

Sadakaja i shërben njeriut si hije mbrojtëse në ditën e Gjykimit- Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem, tek kategoritë e personave që do të jenë nën hijen e Arshit të Allahut, ditën e Gjykimit është personi që jep sadaka fshehurazi saqë dora e majtë nuk e di çfarë ka dhënë dora e djathët.” (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Sadakaja është shkak për shërimin e sëmundjeve- Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem, ka thënë: ”*Shëroni të sëmurët tuaj me sadaka.*” (Transmeton Taberani)

Këto janë vetëm disa nga vlerat e sadakasë, prandaj më e preferuara edhe në bazë të haditheve është sadakaja fshehurazi në mënyrë që njeriu ta ruajë sinqeritetin e tij dhe të ketë kujdes nga syefaqësia. Gjithashtu ai që e jep sadakanë duhet të ketë kujdes që të mos ia përmend sadakanë e tij personit që po ia jep, sepse në këtë mënyrë ka mundësi ta zhvlersojë veprën e tij, por ai duhet ta falënderoj Allahun që po ia mundeson ta bëjë këtë vepër të mirë, frytet e së cilës do t'i sheh me lejen e Allahut në ditën e Gjykimit.

AGJËRIMI

Agjërimi është shtylla e katërt prej shtyllave të islamit. Me fjalën “*es-savm*”, në kuqtimin gjuhësor është për qëllim abstenimi, largimi dhe përbajtja nga veprimi i diçkaje. Kurse në aspektin terminologjik nënkuptohet, ”*Largimi nga çdo gjë që e prish agjërimin në kohën e para agimit të diellit deri në perëndimin e tij.*”

Allahu i Lartësuar thotë në Kuran për agjërimin: ”**O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.**” (Bekare, 183)

Rëndësia e agjërimit dhe Ramazanit

Agjërimi është prej veprave për të cilat Allahu në hadith kudsi ka thënë: ”*Agjërimi është për mua dhe unë shpërbuje për të*” edhe pse veprat e tjera të mira shpërbulehen nga dhjetë deri shtatëqindfish, Allahu nuk e ka përkufizuar shpërblimin e agjërimit me numër të caktuar por e ka shumfishuar atë.

Agjërimi është një ibadet i cili në vete përmban sabrin, sepse në të ka durim në respekt ndaj urdhërit të Allahut, durim nga gjërat që Allahu ia ka ndaluar gjatë ditës në tërë këtë muaj dhe durim

në etjen dhe urinë që e kaplon agjéruesin. Besimtari i cili agjéron e di se knaqësia e All-lahut është në lënien e epsheve dhe i jep përparësi knaqësisë së All-lahut, para epsheve të tij.

Agjërimi është gjë e fshehtë mes Zotit dhe robit të vet, sepse këtë ibadet nuk e sheh askush përvëç Allahut.

Por çfarë duhet pasur kujdes agjéruesi gjatë agjérimit?

Largimi nga gjërat e ndaluara gjatë agjérimit (ushqimi, pijs, kontakti seksual), nuk plotësohet derisa njeriu nuk largohet edhe nga gjërat tjera të ndaluara siç janë gënjeshtra, padrejtësia, fjalët e kota, shkelja e nderit, pasurisë etj... Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem, ka thënë: "*Kush nuk i lë fjalët e rrejshme dhe veprimin sipas tyre, Allahu nuk ka nevojë që ky person ta lë ushqimin dhe pijen.*" (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Agjéruesi ka dy gëzime:

- Gëzimi i tij gjatë iftarit ndodh sepse natyra e njeriut është të anojë nga gjërat e zakonshme si ushqimi, pijs dhe kontakti dhe skadimi i kohës së ndalimit e gëzon agjéruesin. Agjéruesi që ka braktisë epshet e tij gjatë ditës, të njejtat i përdorë gjatë natës sepse i ka lënë sipas urdhërit të All-lahut dhe u kthehet atyre sipas urdhërit të Allahut dhe në të dyja rastet është rob që respekton Zotin e vet.

- Gëzimi i tij kur ta takojë Allahun nga shkaku i shpërblimit që i është rezervuar atje, në momentin që do të ketë nevojë më së shumti.

Vërtetimi i fillimit të Ramazanit bëhet në dy mënyra:

1. Plotësimi i muajit Shaban për 30 ditë dhe
2. Të vrejturit e hënës së re me perëndim të diellit të ditës së 29 të muajit Shaban

Kushtet e vlefshmërisë së agjërimit

- Nijeti (qëllimi), duhet bërë nijet për agjërim me zemër dhe ky njet bëhet para syfirit
- Largimi nga çdo gjë që e prish agjërimin
- Femra të mos jetë me hajz (cikël menstrual) dhe lehonî

Kushtet e agjëruesit

1. Të jetë musliman
2. I mençur
3. I rritur

(Nëse fëmija agjëron i lejohet dhe për këtë shpërblehet nga Allahu i Lartësuar)

Kujt i lejohet të mos agjërojë

1. I sëmuri
2. Udhëtarë

3. Gruas shtatëzënë dhe gjidhënëse (kjo vlen vetëm nëse ka ndonjë problem shëndetësor, nëna apo fëmiu përndryshe nëse agjërimi nuk i shkakton problem e ka obligim atë)
4. I moshari që është i dobët dhe agjërimi ia rëndon gjendjen.

Sunnetet e agjërimit

1. Zgjimi për syfyr dhe vonimi i tij
2. Shpejtimi për iftar
3. Shtimi i duave
4. Namazi i taravive
5. Dhënia e sadakasë
6. Shtimi i ibadetit sidomos në netët e fundit të Ramazanit,
7. Të dhënurit iftar atyre që janë agjërueshëm
8. Leximi i shumtë i Kuran-it, pasi Ramazani është muaji i Kuran-it

Çka e prish agjërimin:

1. Ngrënia dhe pirja me qëllim
2. Të vjellurit me qëllim
3. Kontakti bashkëshortor
4. Cikli menstrual dhe lehonisë

Agjërimi dhe llojet e tij:

Agjërimi farz

1. Agjërimin e muajit të Ramazanit
2. Agjérmin për t'i kompenzuar ditët e pa agjëruara në ramazan dhe
3. Agjërimin e betimit (nëse je betuar për ndonjë ditë që do të agjërosh) e ke farz agjërimin e asaj dite

Agjërimi sunnet:

1. Agjërimi i ditës së hënë dhe të enjte
2. Dhjetë ditët e Dhulhixhes
3. Agjërimi gjatë muajit Muharem, posaçërisht ditën e Ashurës (duke e pasuar me një ditë para)
4. Agjërimi i pjesës më të madhe të muajit Shaban
5. Agjërimi i tri ditëve prej çdo muaji (e preferuar dita 13, 14, 15)
6. Agjërimi një ditë po dhe një ditë jo (agjërimi i Davudit),
7. Agjërimi i gjashtë ditëve të muajit Sheval

Ditët në të cilat ndalohet agjërimi janë: dita e Fitër Bjaramit dhe katër ditët e Kurban Bajramit (të njoitura si ditët e teshrikut).

Këshilla praktike të shfrytëzimit të muajit Ramazan

Ramazani është muaj i veçantë që dallon nga muajt e tjera, dhe ardhja e tij sjellë një freski dhe ndryshim të rutinës së besimtarit, dhe është një muaj që duhet kushtuar kujdes dhe shfrytëzuar në maksimum për vepra të mira. Çfarë duhet të kemi parasysh gjatë muajit Ramazan?

- Nijeti-** Besimtari kur agjeron nuk duhet të shikojë agjérimin e tij vetëm në aspektin e obligimit pavarësisht se duhet ta kryej këtë obligim, por nijetin e tij për agjérим mund ta rregulloj në atë formë që t'a shumfishojë shpërblimin e agjérimit. Të llogarisë që agjérimin e tij po e kryen duke respektuar një urdhër të Allahut, duke shpresuar në shpërblimin e tij të pakufizuar dhe faljen e mëkateve. Po ashtu agjérimin e tij ta llogarisë ndërmejtësues për të ditën e Gjykimit. Ta bëjë nijet që me këtë agjérim të hyjë në xhennet nga dera e agjéruesve. Gjithashtu ditët e agjérimit t'i bëjë nijet për dua sepse ka argumente që duaja e agjéruesit nuk refuzohet. Sa më shumë nijete që bënë agjéruesi shpërblimet janë më të mëdha.
- Leximi i Kur'anit-** Muaji Ramazan është muaji i Kur'anit dhe leximi e meditimi i tij gjatë këtij muaji ka shpërblime

të shumta. Besimtari duhet të paktën një hatme t'a përfundojë gjatë ramazanit kurse ai i cili ende nuk e di leximin e Kur'anit është e preferuar që ta mësojë leximin e tij para se të arrijë ramazani në mënyrë që të ketë mundësi ta shfrytëzojë muajin e ramazanit për lexim. Përpos leximit të Kur'anit është e preferuar të lexohet edhe tefsir (komentimi i Kur'anit), sepse esenca e leximit të Kur'anit është të mësuarit dhe kuptimi i tij, në mënyrë që robi atë që e mëson ta praktikojë.

3. **Dhikri-** Përmendja e Allahut, përpos dhikirit të mëngjesit dhe mbrëmjes besimtari duhet t'i kushtojë rëndësi edhe dhikreve të tjera për të cilat ka argumepte që peshojnë rëndë dhe që bëhen shkak për falje të mëkateve, siç janë shtimi i dhikreve: La ilah il-lAllah, Allahu ekber, Subhanallah, La havle ve la kuvete il-la bilah, Elhamdulilah, Subhanallahil Adhim, Subhanallahi ve bihamdihi, Estagfirullah. Gjithashtu edhe shtimi i salavateve pasi ato i prezantohen Pejgamberit alejhi selam dhe janë shkak që robin t'a përfshijë ndërmejtësimi i tij në ditën e llogarisë.
4. **Namazi i natës-** Shtimi i namazeve vullnetare në muajin e Ramazanit pasi ato shpërblehen sa namazet farze jashtë tij. Pjesa më e preferuar është pjesa e tretë e natës. T'i

kushtojmë rëndësi edhe përuljes në namaz dhe koncentrimi rreth asaj që e lexojmë që t'a përjetojmë namazin, po ashtu t'a shfrytëzojmë këtë pjesë të natës edhe për istigfar (kërkim falje), sa të kemi mundësi.

5. **Sadakaja-** Është prej veprave të cilat po ashtu u shumëfishohet shpërblimi në muajin Ramazan. Prandaj aq sa është mundësia të jepet sadaka në ramazan duke shfrytëzuar rastet ku ka më së shumti nevojë. Pjesë e saj mund të llogaritet edhe iftari që jep agjéruesi për agjéruesin dhe shpërblimin që e merr, të mos lihen anash të varfërit e shoqërisë nëpër iftare sepse ndejat e tilla konsiderohen më të bereqetshme sesa aty ku thirren vetëm të pasurit.

HAXHI

Shtylla e pestë e islamit është Haxh-i. Fjala “*Haxh*”, në kuptimin etimologjik do të thotë, synim, qëllim, mësymje kurse në atë terminologjik nënkuptohet ”*synimi për të vizituar Qabenë në kohë të caktuar dhe me mënyra të caktuara.*”

Haxhi ka egzistuar si një detyrim i caktuar për njerëzit qysh nga koha e Ibrahimit alejhi selam. Allahu i Lartësuar thotë në Kur'an: ”**Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabesë) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi tek ajo...**” Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem ka thënë: ”*O ju njerëz u është bërë obligim haxhi, kryjeni atë.*” (Transmeton Muslimi).

Dobitë e Haxhit

Haxhi është një adhurim me vlerë të madhe dhe me dobi të shumta për jetën e besimtarit. Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem, ka thënë: ”*Kush e kryen haxhin duke mos bërë punë të liga gjatë tij, ai kthehet sikurse atë ditë që e ka lindur nëna.*” (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)... Gjithashtu Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem, thotë: ”*Umreja deri në umrën tjetër është shlyerse e mëkateve mes tyre, kurse për haxhin e pranuar s'ka shpërblim tjetër pos xhennetit.*” (Transmeton Buhariu dhe Muslimi).

Disa nga dobitë e haxhit janë:

- Forcimi i imanit- Forcimi i lidhjes me Allahun, haxhiu vesh ihramin e tij i kryen ritualet e haxhit dhe afrohet tek Allahu me vepra të mira.
- Haxhi ia mëson njeriut sabrin- Prania e madhe e njerëzve në haxh, mundimet duke kaluar nga një vend në tjetër, ndalesat gjatë kohës së ihramit të gjitha këto e kalitin njeriun me sabër.
- Forcimi i lidhjes vëllazërore- Pasi është vend që i mbledh besimtarët e botës me një qëllim të përbashkët, kryerjen e urdhërit të Allahut duke i bërë të nejtat rite dhe adhurime. Po ashtu edhe barazia mes njerëzve pa dallim race, pasurie apo pozite.
- Njohja e historisë islame- Aty i sheh dhe viziton vendet që dikur vetëm ke dëgjuar për to, aty e sheh vendin ku ka jetuar dhe vepruar vet Pejgamberi alejhi selam, sahabet si dhe përpjekjet që e kanë dhënë për këtë fe.

Obligueshmëria e haxhit

Haxhi është obligim inividual për:

- Çdo musliman
- I rritur
- I shëndoshë mentalisht
- Me mundësi materiale për haxh

Sa i përket femrës, ajo duhet të jetë në shoqërimin e mahremit të saj si dhe nuk duhet të jetë në periudhën e idetit(pritjes), pas shkurorëzimit apo vdekjes së burrit.

Duhet pasur kujdes, nëse personi i plotëson kushtet për kryerjen e haxhit atëherë nuk lejohet vonimi i tij, por duhet shfrytëzuar rasti dhe të kryhet obligimi sa më parë, sepse njeriu nuk e di më vonë a do i jepet kjo mundësi. Personi i cili nuk e përfundon haxhin duke pasur mundësi ta bëjë një veprim të tillë llogaritet mëkatar.

Llojet e haxhit:

Haxhi Kiran- haxhiu ne mikat (vend ku fillon rituali i haxhit), e bën nijet ta kryej Umren dhe Haxhin pa u liruar prej i hramit mes umres dhe haxhit. Kur arrin në Mekke e përfundon umren dhe

qëndron në iherama deri të përfundojë haxhin. Për këtë lloj haxhi e ka detyrim të presë Kurban.

Haxhi Temet’tu- haxhiu në mikat e bën nijet Umren dhe kur arrin në Mekke kryen umren, pastaj e heq iheramin dhe ashtu qëndron deri në diten e tetë të Dhulhixhes, ku e vesh iheramin dhe vendos për kryerjen e Haxhit. Ky person duhet të presë kurban nëse ka mundësi, nëse jo agjeron tri ditë në Mekke e shtatë ditë kur kthehet në shtëpi.

Haxhi Ifrad- haxhiu bën nijet ta kryejë vetëm Haxhin.

Shtyllat e haxhit

Qëndrimi në Arafat- është prej kushteve kryesore të haxhit pa të cilën haxhi nuk ka vlerë. Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi vesse-l-lem, ka thënë: ”*Haxhi është qëndrimi në Arafat.*”

(Transmeton Buhariu)...Koha e qëndrimit në Arafat fillon prej namazit të drekës në ditën e nëntë dhulhixhe (dita e Arafatit), vazhdon deri në aksham).

Tavaful Ifadah- ky tavaf bëhet pas hedhjes së gurëve në ditën e parë, të dytë dhe të tretë të Kurban Bajramit. Është tavafi i haxhit, që bëhet në ditën e dhjetë të dhulhixhes.

Farzet e haxhit

Ihrami- përbëhet nga dy pjesë: e sipërme dhe e poshtme, me veshjen e saj nënkuptohet që haxhiu ka bërë nijetin që të hyjë në ritualin e haxhit ose umres, ndërsa ky një bëhet me zemër.

Sunnete para veshjes së ihamrit:

- Pastrimi
- Parfumosja e trupit, jo ihamrev
- Këndimi i telbijes Lebejk All-lahume lebejk, lebejl la sherike lele lebejk...

Ndalesat pas veshjes së ihamreve:

- Prerja e thonjëve
- Prerja e flokëve apo rruajtja
- Parfumosja
- Largimi i qimeve nga vendet e turpshme dhe sqetullave
- Gjetia e tokës
- Kontakti seksual
- Fjalosja
- Të thyerit e pemëve në harem
- Veshja e rrobave që janë të kufizuara në formë të gjymtyrëve të trupit

Sa'ji (vrapimi) mes kodrave Saffa dhe Merva- fillon prej kodrës Saffa deri tek Merva, e që llogaritet njëherë, pastaj prej Merves deri tek Saffa që i bie hera e dytë, kështu derisa të bëhen shtatë vajtje-ardhje. Saji bëhet në këmbë për personin që është i aftë të ecë, kurse për atë që nuk ka mundësi lejohet të bartet me mjete. Saji kryhet pas tavafit.

Qëndrimi në Muzdelife- është obligim qëndrimi apo bujtja në Muzdelife, aty falet bashkë namazi i akshamit dhe jacisë, po ashtu falet edhe namazi i sabahut më pas preferohet të bëhet dua, kurse pak para lindje së diellit duhet nisur për Mina.

Hedhja e gurëve- në xhemerat që në ditën e parë të bajramit gjuhen tek xhemera e madhe shtatë gurë një nga një. Kurse në ditën e dytë dhe të tretë gjuhen në tri xhemerat nga shtatë gurë. Gjatë gjujatjes duhet thënë Allahu ekber.

Rruajtja dhe prerja e flokëve- rruajtja është më e mirë se vetëm prerja për meshkujt, kurse për femrat prehen afërsisht 2-3 cm. Shkurtimi bëhet ne ditën e dhjetë pas tavafit dhe hedhjes së gurëve në xhemren e madhe dhe zgjatë deri ditën e tretë të bajramit.

Tavaful veda (lamtumirës)- është obligim për haxhiun që nuk është nga Meka dhe jo për vendasin. Femra lirohet nga ky tavaf nëse është me cikël menstrual. Nëse dilet nga Meka pa e kryer

këtë tavaf dhe nuk ka mundësi kthimi, duhet të pres një dele për kompenzim për shkak të lënies së një obligimi.

Haxhillëku për dikë tjetër

Lejohet të autorizohet dikush tjetër për ta kryer haxhin në vend të personit që është i sëmurë dhe s'ka shpresë për shërim si dhe për personin që nuk është i aftë fizikisht, por harxhimet janë barrë e atij për të cilin po kryhet haxhi. E njejtë vlen edhe për të vdekurin që nuk ka pasur mundësi ta kryejë haxhin, mirëpo personi që autorizohet për haxh është kusht ta ketë përfunduar haxhin për vete.

Hedji (kurbani i haxhit)

Hedj quhet kurbani që dërgohet të prehet në harem. Ajo mund të jetë deve, lopë, dash, dhi pra çdo shtazë që vlen për kurban. Hedji për llojin e haxhit Kiran dhe Temmet’tu prehet gjatë ditëve të Kurban Bajramit. Ky mish shpërndahet për të varfërit brenda dhe jashtë haremit.

Vizita e xhamisë së Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem

Kjo vizitë është e pëlqyer dhe mund të bëhet në çdo kohë para apo pas përfundimit të haxhit. Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem ka thënë: ”*Nuk synohet me udhëtim asnje xhami*

tjetër vetëm se për tri xhami: Mesxhidul Haram, në xhaminë time dhe mesxhidul Aksa.” (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Falja në xhaminë e të Dërguarit sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem, ka vlerë të madhe dhe shpërblim të madh siç ka thënë edhe vet ai sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem: ”*Namazi në xhaminë time është më i vlefshëm sesa njëmijë namaze në xhamitë tjera përpos Mesxhidul Haramit (Qabesë).*” E preferuar është falja e dy rekateve sunnet pas hyrjes në xhami si namaz nderimi.

Umra

Me shprehjen “*Umre*”, në kuptimin gjuhësor do të thotë vizita, kurse në kuptimin terminologjik ”*vizita e Qabesë me nijet që gjatë vizitës të kryhen ritet e caktuara.*” Për vlerën e umres Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem, ka thënë: ”*Umra deri në umra është falje e mëkateve që bëhen mes tyre, kurse haxhi i pranuar ka shpërblim xhennetin.*”

Veprimet gjatë umres:

1. Ihrami- bërja nijet për ta bërë umren, në Mikat dhe veshja e ihmamëve nga aty para se të hyjë në Mekë
2. Tavafi rrëth Qabesë
3. Ecja mes kodrave Saffa dhe Merva
4. Shkurtimi apo rruajtja e kokës

Këto janë disa nga veprimet kryesore të haxhit dhe umres. Allahu na mundësoftë kryerjen e këtij obligimi madhor.

Kurbani

Me fjalën “*Kurban*”, në sheriatin islam nënkuptohet therrja e kafshës apo prerja që është hallall t'i hahet mishi me qëllim të afrimit tek Allahu i Lartësuar. Kurbani më i mirë është ai që prehet ditëve të Kurban Bjaramit.

Të therurit e kurbanit për Kurban Bajram është sunnet i fortë sipas shumicës së dijetarëve për muslimanin e rritur, të aftë mentalisht, të lirë (jo rob), dhe i pasur d.m.th. që ka mundësi të prejë kurban. Koha e prerjes së kurbanit fillon pasi të falet namazi i bajramit deri në perëndimin e ditës së tretë të Kurban Bajramit.

Kushtet që duhet t'i plotësojë Kurbani:

- Kurbani të jetë bagëti, dele, lopë, buallicë dhe deve
- Kurbani të jetë pa të meta dhe i shëndoshë (të mos jetë e verbër, të mos çalojë, të mos e ketë të këputur gjysmën e më shumë të veshit ose të bishtit)
- Kurbani t'i ketë vitet e duhura. Delja lejohet të jetë 6-7 muajshe, kurse dhia duhet të mbushi një vit. Lopa apo buallica duhet t'i kenë dy vite, kurse deveja pesë

Kurbani i dhisë dhe deles koniderohet një hise, kurse tek kafshët e mëdha si lopa, buallica dhe deveja lejohet të marrin pjesë deri në shtatë persona vlen për shtatë familje. Kurbani i prerë ndahet në tri pjesë: një pjesë ndalet për familjen, një pjesë iu jepet të afërmve dhe një pjesë të varférve.

Literatura

1. Jahja Ibn Izet, “**DËSHMIA LA ILAHE IL-LALLAH MUHAMMEDUN RESULLAH**”, pa vit botimi.
2. Mr Flamur Sofiu, “**FIKHUL IBADAT**” vit.2009.
3. Flamur Kabashi, “**PËRMBLEDHJE E DISPOZITAVE TË ZEKATIT**” vit. 2018.
4. Abdullah b.Salih El-Kusajjir, “**PASQYRË RRETH ZEKATIT TË FITRIT**” viti 2010.

Përbajtja:

Parathënie	4
SHTYLLAT E ISLAMIT	5
KUSHTET E FJALËS “LAILAHE IL-ALL-LAH”	7
SHTYLLAT E DËSHMISË “MUHAMMEDUN RESULULLAH”	15
NAMAZI	19
Namazi i xumasë.....	24
Namazet vullnetare.....	25
Namazet tjera vullnetare	25
Shembuj praktikë të përulësisë në namaz.....	26
ZEKATI	29
Pozita e zekatit në islam	29
Zekati i fitrit (<i>sadakatulfitri</i>).....	32
Vlera e sadakasë	35
AGJËRIMI.....	37
HAXHI	45
Dobitë e Haxhit	45
Obligueshmëria e haxhit	47
Shtyllat e haxhit	48

Farzet e haxhit	49
Haxhillëku për dikë tjetër	51
Hedji (kurbani i haxhit)	51
Vizita e xhamisë së Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem	51
Umra.....	52
Kurbani	53
Literatura.....	55